



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 880/Prot. 2

Tiranë, më 02.04 2019

**Lënda:** Kërkesë për plotësim dokumentacioni

**ZNJ. ALMARINA MUSTAFA NASTIMI**

Adresa: Këshilli i Bashkisë Devoll

**Për dijjeni:**

**KËSHILLIT TË BASHKISË DEVOLL**

Adresa: Rr. "24 Tetori", Lagjja nr.1, Devoll

**PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

Adresa: Rr. Bulevardi "Zhan D' Ark", nr. 11, Tiranë

Me shkresën nr. 764 prot., datë 27.02.2019, Këshilli i Bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Këshill, vakancë kjo e krijuar nga Këshilltari, z. Çlirim Fatmir Hoxha, propozuar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), znj. Tatjana Gurtali Çausi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 880/1 prot., datë 13.03.2019 i është drejtuar znj. Tatjana Gurtali Çausi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilës i kalon mandati i Këshilltares.

Znj. Tatjana Gurtali Çausi, nuk e dorëzoi formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda afatit ligjor 10 ditor.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", kreu II, pika 3, parashikon se: "Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, atëhere organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.



Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 21 (njëzetë e një), znj. Almarina Mustafa Nastimi, sipas listës shumëmemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Devoll.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumëmemërore për këshillin bashkiak për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, kandidati i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, znj. Almarina Mustafa Nastimi, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidatit, nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e saj. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me afishimin e kësaj shpallje, kandidatët vihet në dijeni për njoftimin e tyre për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Afati i dorëzimit fillon nga data e publikimit të kësaj shpallje.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me Kreun II, pika 7, dhe kreun III, pika 2, e Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**KRYETAR**  
**Klement ZGURI**

